



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 130
Prishtinë, më 27 qershor 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 27 QERSHOR DHE MË 4 KORRIK 2013**

Mbledhjen e drejtoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Burim Ramadani, Bekim Haxhiu dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Danush Ademi parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me mundësinë e përfshirjes së një rekomandimi shtesë në Ligjin për skemat sociale, neni 4, paragrafi 4.5 dhe të sillet për votim në Kuvend.

Ministri Nenad Rashiq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me atë se a keni menduar për të ndarë nga buxheti i Republikës së Kosovës ndonjë shumë financiare për ndonjë program që e preferojnë ekspertët që ka të bëjë me parandalimin e vdekjeve nga ethet hemorragjike, në komunën e Malishevës dhe zonat tjera të prekura?

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Halit Krasniqi.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat që janë ndërmarrë deri më tani nga institucionet shtetërore, të cilat nuk janë të mjaftueshme. A duhet të hartojë programe tjera Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e vdekjeve nga ethet hemorragjike, në komunën e Malishevës dhe zonat tjera të prekura? Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje,
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit të Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012,
7. Njoftim për propozimin e Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar ZB për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare të Kuvendit

* * *

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 20 qershor 2013, pa asnjë vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se arritja e Marrëveshjes ndërlidhet me qëllimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të respektohet në tërësi obligimi kushtetues për zbatimin e pikës 5 të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës e të Serbisë, të aprovuar nga një shumicë e madhe demokratike e Kuvendit të Kosovës, në tetor 2012.

Jemi dëshmitarë se të gjitha dilemat dhe kundërshtimet rreth ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë u rrëzuan kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dha verdiktin me të cilin theksohet dhe argumentohet se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

Krijimi i marrëdhënieve të mira ndërmjet shteteve fqinje në rajonin tonë është parakusht për stabilitet, për sundim të ligjit, për zhvillim ekonomik dhe për zhvillimin e përgjithshëm dhe integrimin në Bashkim Evropian dhe në NATO.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së, e datës 9 shtator 2010, e cila e fton, si Kosovën, ashtu edhe Serbinë, që si dy shtete të pavarura ta fillojnë punën për normalizimin e marrëdhënieve të ndërsjella nëpërmjet një dialogu teknik.

Ne të gjithë e kemi ditur që nga fillimi se procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të jetë fare i lehtë.

Fazën fillestare për normalizim e filluam me dialogun teknik për zgjidhjen e një sërë çështjesh dhe rezultatet që dha dialogu teknik kanë rrëzuar parashikimet e shumë skeptikëve dhe kundërshtarëve më të mëdhenj të këtij dialogu.

Dialogu teknik rezultoi me një numër të marrëveshjeve të arritura, me përfaqësimin e Republikës së Kosovës në forumet rajonale dhe më gjerë, vendosjen e kufijve shtetërorë në të gjitha pikat kufitare dhe aplikimin e sistemit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Më pas tha se tashmë kemi arritjen e numrit treshifror (100) në njohjet e shtetit të Kosovës, kemi anëtarësimin në institucione ndërkombëtare dhe rajonale, të cilat në gjirin e tyre pranojnë vetëm shtetet, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kemi anëtarësimin në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, kemi vendimin për pranim në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, njohjet e reja dhe anëtarësimet në organizata rajonale dhe ndërkombëtare pritet të bëhen në vazhdimësi.

Mbi të gjitha, si rrjedhojë e punës sonë serioze në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe si rezultat i përmbushjes së standardeve evropiane, Kosova tashmë e ka marrë dritën jeshile për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për Kosovën, ku trajtohet si shtet, si të gjitha shtetet tjera.

Pas njëmbëdhjetë rundeve të dialogut politik, më 19 prill 2013 u arrit Marrëveshja e parë historike ndërshtetërore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të BE-së, baroneshës Eshton dhe mbështetjen e fuqishme të SHBA-ve, theksoi kryeministri.

Marrëveshja, të cilën sipas rregullave për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare po e paraqesim sot për ratifikim para jush, përmban 15 pika, të cilat i rregullojnë aspektet thelbësore për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Marrëveshja hap rrugën për vendosjen e stabilitetit në veri të Kosovës nëpërmjet transformimit rrënjësor të gjendjes aktuale të sigurisë, si dhe të kushteve politike dhe ekonomike.

Marrëveshja hap perspektivën e Kosovës për ta përmbyllur procesin e njohjeve ndërkombëtare dhe anëtarësimin e Kosovës në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe OKB-në.

Marrëveshja siguron dhe plani i implementimit vendos detajet që deri në mes të muajit korrik 2013, Serbia do t'i mbyllë të gjitha strukturat e saj të sigurisë në Kosovë dhe të përfundojë ofrimin e përkrahjes financiare.

Tashmë e dimë se Qeveria e Serbisë ka marrë vendim për ndalimin e financimit të atyre strukturave ilegale të sigurisë dhe tashmë janë mbyllur disa stacione policore të MUP-it, të cilat në mënyrë të paligjshme kanë operuar në veri të vendit.

Marrëveshja siguron që Policia e Kosovës do të jetë i vetmi autoritet legal dhe legjitim policor në veri të Kosovës.

Komandanti rajonal i Policisë është emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, e gjithë kjo sipas marrëveshjes.

Marrëveshja konfirmon sistemin unitar ligjor të Republikës së Kosovës si të vetmin autoritet ligjor në vend.

Integrimi me kohë i autoriteteve gjyqësore brenda sistemit ligjor dhe të drejtësisë së Kosovës është esencial dhe ne konsiderojmë se ky kompozim i sistemit gjyqësor do ta rrisë besimin e komuniteteve në gjykatat e Kosovës, do të përmirësojë marrëdhëniet ndëretnike dhe mbi të gjitha do të vendosë sundimin e ligjit në veri të vendit që ka munguar në 14 vjetët e fundit.

Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, ne për herë të parë pas 14 vjetëve, do të jemi në gjendje të organizojmë zgjedhjet komunale në veri të Kosovës në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën mënyrë, siç do të bëhet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Një aspekt tjetër i marrëveshjes është formimi i asociacionit të komunave serbe, i cili do të funksionojë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Prandaj, ju garantoj se gjithçka është e aranzhuar në atë mënyrë që të respektohen plotësisht Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës.

Në fund, kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Legjislacion lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji e paraqiti deputeti, Arben Gashi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Blerim Shala, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar KKR, Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ZB, Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Muhamet Mustafa, Glauk Konjufca, Emilija Rexhepi, Afrim Hoti, Rexhep Selimi, Albulena Haxhiu, Albin Kurti, Liburn

Aliu, Jakup Krasniqi dhe Florim Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në ndërkohë deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” dolën para foltores duke mbajtur në dorë pano me mbishkrime të ndryshme.

Kryetari kërkoi nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” që të heqin dorë nga këto veprime, që ata të ulen në vendet e tyre në mënyrë që Kuvendi të mund t’i zhvillojë punimet e seancës plenare normalisht.

Ai më pas caktoi një pauzë 15 minutëshe.

Pas pauzës kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----84 ,
Kundër----- 3 ,
Abstenime----- 1 .

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

2. Ligji i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës, për shpallje.

5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Kryetari njoftoi deputetët se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Më tej, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Fatmir Xhelili - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Anton Çuni - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar KKR, Goran Marinković - në emër të Grupit Parlamentar ZB dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas, kryetari konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të hyjnë në procedurën e votimit. Ai procedoi me diskutimet për pikat e radhës.

6. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion tha se si Komision kemi shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar mosmiratimin e tij.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Halit Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas kryetari konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të hyjnë në procedurën e votimit. Ai procedoi me diskutimet për pikën e radhës.

7. Njoftim për propozimin e Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar 'ZB' për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit

Kryetari njoftoi deputetët në lidhje me propozimin e GP SLS dhe GP ZB, për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit:

I. Grupi Parlamentar SLS ka propozuar ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, si në vijim:

Deputeti Hamza Balje, propozohet anëtar në Komisionin parlamentar për Punë të Jashtme, në vend të deputetit Petar Miletqi,

Deputeti Sreten Ivanoviq, propozohet anëtar në Komisionin parlamentar për Legjislacion, në vend të deputetes Jasmina Zhivkoviq.

II. Grupi Parlamentar ZB ka propozuar ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, si në vijim:

Deputetja Vesna Mikiq propozohet anëtar në Komisionin parlamentar për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të deputetit Goran Marinkoviq,

Deputeti Etem Arifi, propozohet anëtar në Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetes, Biserka Kostiq,

Deputeti Vesimir Saviq propozohet zëvendëskryetar i dytë në Komisionin parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në vend të deputetit Boban Todoroviq.

Më pas kryetari konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit nuk mund të hyjnë në procedurën e votimit.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi përfundoi punimet për ditën e sotme, ndërsa për vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare tha se do të vendoset në mbledhjen e Kryesisë, me kryetarët e grupeve parlamentare, më datë 1 korrik 2013.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 16 : 30 minuta.

* * *

4 korrik e enjte ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 27 qershor 2013.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, **Xhavit HALITI**.

Kryesuesi deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 27 qershor 2013.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë.

Ai procedoi me votim për pikat si në vijim:

1. Votimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Kryesuesi tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare të mbajtur më 27 qershor 2013, mirëpo në mungesë të kuorumit votimi është shtyrë për ditën e sotme.

Kryesuesi hodhi në votim raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 58,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi raportin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

2. Votimi i raportit të Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012

Kryesuesi hodhi në votim raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte:

Për----- 55,
Kundër----- 9,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012.

3. Votimi i propozimit të Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar ZB për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare të Kuvendit

Kryesuesi kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të miratojnë propozimin e Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar ZB për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare të Kuvendit.

Kuvendi miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M
Për emërimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare

I. Emërimet nga Grupi Parlamentar SLS

1. Deputeti Hamza Balje, emërohet anëtar në Komisionin parlamentar për Punë të Jashtme, në vend të deputetit Petar Miletqi,
2. Deputeti Sreten Ivanoviq, emërohet anëtar në Komisionin parlamentar për Legjislacion, në vend të deputetes Jasmina Zhivkoviq.

II. Emërimet nga Grupi Parlamentar ZB

1. Deputetja Vesna Mikiq, emërohet anëtare në Komisionin parlamentar për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të deputetit Goran Marinkoviq,
2. Deputeti Etem Arifi, emërohet anëtar në Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetes Biserka Kostiq,
3. Deputeti Vesimir Saviq emërohet zëvendës kryetar i dytë në Komisionin parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë, në vend të deputetit Boban Todoroviq.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

* * *

Kryesuesi i përfundoi punimet e mbledhjes plenare në orën 10:35.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*